



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 05 janar 2021
Nr. ref.:RK 1686/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI144/20

Parashtrues

Qerim Qerimi

**Kërkesë për vlerësim të kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 214/2020, të 13 korrikut 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSVËS

Arta Rama-Hajrizi, kryetare,
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar,
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare,
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Qerim Qerimi nga fshati Dumnice, Komuna e Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Ramiz Suku, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme) Rev. nr. 214/2020 të 13 korrikut 2020.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të kontestuar të Gjykatës Supreme, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave dhe lirive të tij të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), si dhe me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 shtator 2020, parashtruesi i kërkesës përmes postës dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 tetor 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
7. Më 21 tetor 2020, Gjykata njoftoi përfaqësuesin ligjor të parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
8. Më 10 dhjetor 2020, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Nga shkresat e lëndës rezulton se objekt i kontestit i cili daton që nga viti 1977, është ngastra kadastrale 3001/15, me kulturë shtëpi banimi me sipërfaqe prej 140 metra katror dhe oborr me sipërfaqe prej 439 metra katror, në vendin e quajtur “Livadhet e Mëdha”, në rrugën “Mehmet Pashë Zogaj”, e evidentuar në emërto të paditurit E.B., e cila, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ishte fituar me kontributin e përbashkët familjar të parashtruesit të kërkesës dhe të paditurit.

10. Parashtruesi i kërkesës së bashku me dy të afërm të tij të ngushtë (paditës) H.Q. dhe F.Q., paraqitën në Gjykatën Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtrri (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata Themelore) kërkesëpadinë kundër të paditurit E.B., në të cilën kerkuan që atyre t'iu njihet e drejta e pronësisë mbi pronën e kontestuar të përmendur më lart, të cilën e kërkojnë në bazë të ndarjes së pasurisë familjare, e cila, sipas pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, ishte fituar me kontributin e përbashkët në kohën sa ka zgjatur bashkësia familjare, edhe pse ishte evidentuar në emër të të paditurit.
11. Gjatë mbajtjes së seancës shqyrtuese të Gjykatës Themelore në lidhje me kërkesëpadinë, parashtruesi i kërkesës mbeti në tërësi pranë kërkesëpadisë, ndërsa i padituri E.B. kundërshtoi kërkesëpadinë, duke theksuar se pronësinë mbi pronën e kontestuar "...e ka fituar [...] me aktgjykimin C. nr. 357/77, të datës 22 dhjetor 1977, në Gjykatën Komunale të Vushtrrisë, me të cilin u vërtetua bashkëpronësia në pjesë ideale prej $\frac{1}{2}$, të ngastrës amë, me sipërfaqe prej 0.11.60 h dhe pronar u regjistruan E. B. dhe I. Q. në pjesën ideale secili nga $\frac{1}{2}$ të kësaj ngastre. Me kontratën e ndarjes fizike në mes të E. B., dhe I. Q., kjo ngastër ndahet dhe E.B. bëhet pronar i ngastrës së formuar rishtas 3001/15, dhe këtë ndarje fizike e vërteton në Gjykatën Komunale në Vushtrri, Ov. nr. 71/85 datë 8 maj 1985. E.B., më vonë shkëput bashkësinë familjare edhe me babain e tij, paditësin H. Q., me kontratën e shkëputjes së bashkësisë familjare, më 24 janar 1979 me Ov. nr. 62/79 në mes të H.Q., dhe E. B.. Palët janë dakorduar që ta legalizojnë shkëputjen faktike të bashkësisë familjare e cila sipas pohimit të paditurit, është ndërprerë faktikisht në vitin 1978, dhe babai mbetet pronar i pasurisë së paluajtshme në Dumnicë të Poshtme të Vushtrrisë, kurse familjet jetojnë të ndara."
12. Me qëllim të vërtetimit të bazueshmërisë së kërkesëpadisë, Gjykata Themelore kishte angazhuar ekspertë gjyqësor të fushës së gjeodezisë dhe ndërtimtarisë, për të kryer ekspertizat në vendin e ngjarjes dhe për të hartuar raportet e tyre për nevojat e gjykatës, dhe ata e kanë bërë një gjë të tillë.
13. Më 17 qershor 2015, Gjykata Themelore nxori Aktgjykimin C. nr. 18/2011, me të cilin aprovoi kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës, duke përcaktuar si në vijim:
 - I. Vërtetohet** se paditësit H. Q., F. Q., dhe Q. Q. kanë të drejtën e pronësisë në $\frac{1}{2}$ në pronën e paluajtshme e evidentuar në parcelën kadastrale nr. 3001/15, me kulturë shtëpi 140 m² dhe oborr 439 m², me sipërfaqe të përgjithshme prej 579 m², në vendin e quajtur "Livadhet e mëdha" e cila gjendet në rrugën "Mehmet Pashë Zogaj" dhe në pjesën jugore kufizohet me pronën E.H., dhe pjesën perëndimore me pronën e I. Q. ZK Vushtrri.
 - II. Detyrohet** i padituri që paditësve të ua njohi të drejtën e pronësisë si në pikën I në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe të duroj që kjo pasuri të regjistrohet në regjistrin për të drejtat në paluajtshmëri në Drejtorin për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Vushtrri, në afat prej 15 dite pas marrjes së këtij aktgjykimi.
 - III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.**

14. Në arsyetimin e Aktgjykimi të saj, Gjykata Themelore theksoi se: *“Gjykata erdhi në përfundim se pasuria e paluajtshme (oborri dhe shtëpia) e cekur në dispozitivin e këtij aktgjykimi është pasuri e përbashkët e palëve ndërgjyqëse, të cilët me kontributin e tyre kanë krijuar këtë pasuri edhe pse evidentohet në emër të tij, por as i padituri edhe pse pretendon se është pronar i vetëm, nuk e dëshmoi me argumente bindëse apo me marrëveshje me shkrim se është pronar i vetëm i kësaj paluajtshmërie, e cila është krijuar me kontributin e palëve ndërgjyqëse, gjykata vendosi si në dispozitivin e këtij aktgjykimi”.*
15. Kundër Aktgjykimit të përmendur të Gjykatës Themelore, C. nr. 18/2011, brenda afatit ligjor, i padituri E.B. paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) për shkak të shkeljeve të dispozitave të LPK-së, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe për shkak të aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që aktgjykimi i kontestuar të priset dhe lënda të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në riprocedurë dhe rivendosje, ose të ndryshohet në pajtim me pretendimet ankimore.
16. Më 5 dhjetor 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit AC. nr. 3488/2015, aprovoi si të bazuar ankesën e të paditurit E.B. dhe ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në atë mënyrë që kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës dhe dy paditësve të tjerë H.Q. dhe F.Q., e refuzoi si të pabazuar.
17. Gjykata e Apelit në Aktgjykimin e saj theksoi: *...Gjykata e shkallës së parë ka administruar të gjitha provat për vendosjen e kësaj çështje juridike, por provat e administruara i ka vlerësuar gabimisht, dhe gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike, dhe gabimisht e ka aplikuar të drejtën materiale.*

“Gjykata e Apelit gjen se i padituri të drejtën e pronësisë ndaj paluajtshmërisë lëndore e ka fituar në bazë të blerjes e cila është vërtetuar me aktgjykimin C. nr. 357/77 të datës 22.12.1977 të Gjykatës Komunale në Vushtrri në bazë të pranimit dhe në mes tjerash ka vërtetuar se atje paditësit E.B. dhe I.Q. janë bashkëpronar në pjesën prej 1/2 të ngastrës kadastrale numër 3001/12...”.

“Sipas bazës së kontratës për ndarje fizike të lidhur në mes I. Q. (paditësit) dhe E. B. (të paditurit) (me datën 24.01.1979), është bërë ndarja fizike e ngastrës kadastrale 3001/12 në këto dy parcela, ashtu që E. B. në pronën në pjesën 1/1 i ka takuar paluajtshmëria e evidentuar si nk. nr. 3001/15, sipas kulturës shtëpi dhe oborr, në vendin e quajtur “Livadhet e Mëdha”, e cila përbëhet nga shtëpia në sipërfaqe prej 141 m2 dhe oborr 439 m2. Kjo kontratë është vërtetuar pranë Gjykatës Komunale në Vushtrri me datën 22.05.1985, nën Ov. nr. 559/85. Me aktvendimin e SO Vushtrri, Sekretariati për Ekonomi dhe Shërbime 03 numër 353-19 të datës 31.03.1978...”.

“...Sipas gjendjes faktike të cekur, Gjykata e Apelit gjen se i padituri të drejtën e pronësisë ndaj paluajtshmërisë lëndore e ka fituar në bazë të blerjes e cila është vërtetuar me aktgjykim C. nr. 357/77 të datës 22.12.1977, dhe se që nga fillimi, dhe më vonë, si me rastin e ndarjes fizike, ashtu edhe me rastin e ndërtimit të shtëpisë ka vepruar si pronar i vetëm

dhe ekskluziv i së njëjtit. Gjykata e Apelit në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk gjen asnjë argument, asnjë dokument që konfirmon ekzistencën e një bashkësie të jetës dhe ekonomisë në kohën e ndërtimit të shtëpisë në pronën në fjalë. Prandaj sipas pikëpamjes së Gjykatës së Apelit, nuk ka vend për aplikim si të dispozitave të Ligjit për Familjen, me të cilat do të konstatohet fitimi i pasurisë gjatë bashkësisë familje, ashtu as vend për aplikim të dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore, d.m.th., Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, sepse thjesht nuk ka asnjë bazë faktike për të arsyetuar zbatimin e këtyre dispozitave ligjore.”

18. Parashtruesi i kërkesës dhe dy paditësit e tjerë, H.Q. dhe F.Q., brenda afatit ligjor, paraqitën revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës të ndryshohet dhe çështja të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë, duke pretenduar se prona lëndore ishte fituar me kontributin e përbashkët gjatë kohës sa ka zgjatur bashkësia familjare dhe se kontrata e ndarjes është e pavlefshme.
19. Më 13 korrik 2020, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Rev. nr. 214/2020, refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës dhe dy paditësve të tjerë H.Q. dhe F.Q., duke theksuar:

“Duke shqyrtuar aktgjykimet e instancave më të ulta dhe shkresat e lëndës, Gjykata Supreme gjeti se paditësit kishin kërkuar që të ju njihej e drejta e pronësisë në pronën e kërkuar mbi bazën e ndarjes së pasurisë familjare, dhe pretendonin se ishte fituar me kontribut të përbashkët gjatë bashkëjetesës familjare, e cila edhe pse evidentohet në emër të paditurit, ishte fituar me kontributin e përbashkët familjarë të paditësve dhe të paditurit”.

“...sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimi i revizionit se prona ishte fituar me kontribut të përbashkët nuk u provua. Të gjitha dëshmitë e prezantuara, si leja e ndërtimit, kontratat për marrjen e kredisë, dhe përfundimisht evidenca kadastrale, flasin qartë, se përveç që E. B., ka qenë i evidentuar si pronar i ngastrës kadastrale 3001/15, sipas azhurnimit të vitit 1989. godine [...].

Nga ana tjetër pala e paditur, dëshmoi se e ka fituar pronësinë në pajtim me ligjin në fuqi, konkretisht sipas nenit 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 6/80) dhe nenit 13 të Ligjit për Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e RS nr. 45/81), që kanë qenë në fuqi në atë kohë, ku përcaktohet se për të fituar të drejtën pronësore mbi pronën në fjalë, duhet kontratë me shkrim, me nënshkrimet e vërtetuara nga organi kompetent dhe ky fitim i pronësisë, duhet të regjistrohet në librat kadastral. Kontrata ishte vërtetuar në Gjykatën kompetente dhe nuk ishte kontestuar deri në momentin e inicimit të procedurës për vërtetim pronësie”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se „*me aktgjykimin e saj, Gjykata Supreme [...] e refuzon revizionin [dhe] në mënyrë drastike i shkel të drejtat [e tij] për gjykim të drejtë dhe të paanshëm*”.
21. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit Rev. nr. 214/2020, të 13 korrikut 2020, refuzoi revizionin e tij nën pretekstin se i padituri E.B. dhe paditësi H.Q. (djali dhe babai) kanë lidhur kontratën mbi shkëputjen e bashkësisë familjare të vërtetuar nën Ov. nr. 62/79 më 24 janar 1979, e cila kinse është vërtetuar nga Gjykata Komunale në Vushtri.
22. Parashtruesi i kërkesës më tej pretendon se njëri nga paditësit, H.Q., kontestoi kontratën e pretenduar, *“dhe për këtë arsye ai kërkoi përsëritjen e ekspertizës për të përcaktuar vlefshmërinë e kontratës, por kjo është refuzuar nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme”*.
23. Parashtruesi gjithashtu pretendon se Aktgjykimi C. nr. 357/77 i 22 dhjetorit 1977, mbi të cilin Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme bazuan vendimet e tyre, *“nuk mund të jetë provë meqë nuk është “dokument” publik. Rrjedhimisht, aktgjykimi i Gjykatës së Apelit dhe ai i Gjykatës Supreme padyshim se është në kundërshtim me të drejtën pozitive”*.
24. Parashtruesi i kërkesës i drejtohet Gjykatës me kërkesë që të konstatojë se ka pasur shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, dhe rrjedhimisht ta shpallë të palejuar dhe kundërkushtetues Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev. nr. 214/2020.

Pranueshmëria e kërkesës

25. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të parashikuara më tej me Rregullore të punës.
26. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

*“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.
(...)
7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
27. Për më tepër, Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

28. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e ka dorëzuar kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 214/2020, të 13 korrikut 2020, pasi i ka shteruar të gjitha mjetet juridike. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë që pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
29. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafi (2) të Rregullores së punës, i cili përcakton:
- “(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
30. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit, që të shpallë kërkesa të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajtja e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin 2 të rregullit 39 të Rregullores së punës.
31. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si “qartazi e pabazuar” në tërësinë e saj ose vetëm përkitazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të

ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime të “shkallës së katërt”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes”; (iii) pretendime “të pambështetura apo të paarsyetuara”; dhe në fund, (iv) “pretendime “konfuze dhe të paqarta” (shih, më saktësisht për konceptin e papranueshmërisë mbi bazën e një kërkesë të vlerësuar si “qartazi e pabazuar” dhe specifikat e katër kategorive të lartcekura të pretendimeve të kualifikuara si “qartazi të pabazuara”, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së për Kriteret e Pranueshmërisë të 31 gushtit 2019; pjesën III. Papranueshmëria bazuar në merita, A. Kërkesat qartazi të pabazuara, paragrafët 255 deri në 284).

32. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, duke vlerësuar nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtoj thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtruesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë.
33. Sa i përket rastit konkret, Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve për shkelje të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm bazohet në qëndrimin se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme vërtetuan gabimisht gjendjen faktike lidhur me ngastrën në fjalë nr. 3001/15 dhe se ato zbatuan gabimisht të drejtën materiale kur arritën në përfundim se atyre nuk u përket 1/2 e ngastrës në fjalë e cila është fituar në periudhën e kohëzgjatjes së bashkësisë familjare.
34. Në fakt, parashtruesi i kërkesës konsideron se Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme nuk do të duhej të mbështesin përfundimet e tyre në Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Vushttri C. nr. 357/77, të 22 dhjetorit 1977, mbi ndarjen e pasurisë, sepse gjatë procedurës gjyqësore kontrata në fjalë është kontestuar nga paditësi H.Q., si një nga palët në këtë procedurë.
35. Gjykata vëren se Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit AC. nr. 3488/2015, aprovoi si të bazuar ankesën e të paditurit E.B. dhe në mënyrë të detajuar arsyetoi mënyrën e fitimit të pronësisë mbi pronën kontestuese, duke theksuar se:

“...Sipas gjendjes faktike të cekur, Gjykata e Apelit gjen se i padituri të drejtën e pronësisë ndaj paluajtshmërisë lëndore e ka fituar në bazë të blerjes e cila është vërtetuar me aktgjykim C. nr. 357/77 të datës 22.12.1977, dhe se që nga fillimi, dhe më vonë, si me rastin e ndarjes fizike, ashtu edhe me rastin e ndërtimit të shtëpisë ka vepruar si pronar i vetëm dhe ekskluziv i së njëjtit. Gjykata e Apelit në bazë të provave të cilat gjendet në shkresat e lëndës nuk gjen asnjë argument, asnjë dokument që konfirmon ekzistencën e një bashkësie të jetës dhe ekonomisë në kohën e ndërtimit të shtëpisë në pronën në fjalë. Prandaj sipas pikëpamjes së

Gjykatës së Apelit, nuk ka vend për aplikim si të dispozitave të Ligjit për Familjen, me të cilat do të konstatohet fitimi i pasurisë gjatë bashkësisë familje, ashtu as vend për aplikimin e dispozitave të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Pronësore, d.m.th. Ligjit për Marrëdhëniet Detyrimore, sepse thjesht nuk ka asnjë bazë faktike për të arsyetuar zbatimin e këtyre dispozitave ligjore.”

36. Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit Rev. nr. 214/2020 refuzoi, si të pabazuar, kërkesën për revizion të parashtruesit të kërkesës dhe dy paditësve të tjerë H.Q. dhe F.Q., duke theksuar:

“...sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, pretendimi i revizionit se prona ishte fituar me kontribut të përbashkët nuk u provua. Të gjitha dëshmitë e prezantuara, si leja e ndërtimit, kontratat për marrjen e kredisë, dhe përfundimisht evidenca kadastrale, flasin qartë, se përveç që E. B. ka qenë i evidentuar si pronar i ngastrës kadastrale 3001/15, sipas azhurnimit të vitit 1989 [...].

Nga ana tjetër pala e paditur, dëshmoi se e ka fituar pronësinë në pajtim me ligjin në fuqi, konkretisht sipas nenit 33 të Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr. 6/80) dhe nenit 13 të Ligjit për Qarkullimin e Pronës së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare e RS nr. 45/81), që kanë qenë në fuqi në atë kohë, ku përcaktohet se për të fituar të drejtën pronësore mbi pronën në fjalë, duhet kontratë me shkrim, me nënshkrimet e vërtetuara nga organi kompetent dhe ky fitim i pronësisë, duhet të regjistrohet në librat kadastral. Kontrata ishte vërtetuar në Gjykatën kompetente dhe nuk ishte kontestuar deri në momentin e inicimit të procedurës për vërtetim pronësie.”

37. Lidhur me këtë, Gjykata duhet të ritheksojë se parashtruesi i kërkesës para saj, në thelb, ngrit pretendime që ndërlidhen me vërtetimin e gabuar të fakteve dhe zbatimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, pretendime këto të cilat Gjykata, në praktikën e saj të konsoliduar gjyqësore, i konsideron si “pretendime të shkallës së katërt”.
38. Në këtë drejtim, Gjykata, duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe duke marrë parasysh veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së (shih në këtë kontekst, sqarimin në Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. “Shkalla e katërt”, paragrafët 262 dhe 263), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka theksuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtruesi i kërkesës: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A. “Adem Jashari”*, Aktvendim i 28 korrikut 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtruesi i kërkesës: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtruesi i

kërkesës: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).

39. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo vetë nuk mund të vlerësojë faktet që kanë bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *GarcíaRuiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56, dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).
40. Gjykata gjithashtu thekson faktin se në vlerësimin e pretendimeve “të shkallës së katërt” e që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ajo gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është një drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Ky koncept kryesisht në aspektin praktik, në parim, nënkupton (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të kësaj procedure, të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur; dhe se, për pasojë, procedura, marrë si tërësi, do të rezultonte si e drejtë (shih, gjithashtu, Udhëzuesin Praktik të GJEDNJ-së të 30 prillit 2019 për Kriteret e Pranueshmërisë; pjesën I. Papranueshmëria bazuar në merita; A. Kërkesat Qartazi të Pabazuara; 2. “Shkalla e katërt”, paragrafi 264 dhe referencat e përmendura aty). Për më tepër, vlerësimi i drejtësisë së një procedure në tërësinë e saj, është një ndër premisat kryesore të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës, KI128/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtruesi i kërkesës: *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).
41. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat i vërtetimit të gabuar të fakteve dhe interpretimit të gabuar të ligjit, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i ligjit të aplikueshëm nga gjykatat e rregullta, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare. Për më tepër, Gjykata vlerëson se gjykatat e rregullta kanë marrë parasysh të gjitha faktet dhe rrethanat e rastit, pretendimet e parashtruesit të kërkesës të paraqitura përmes padisë, ankesës dhe revizionit dhe kanë arsyetuar të njëjtat (shih, në këtë kontekst, rastin e Gjykatës KI64/20, parashtruesi i kërkesës: *Asllan Meka*, Aktvendim për

papranueshmëri i 3 gushtit 2020, paragrafi 41, dhe KI22/19, cituar më lart, paragrafi 43).

42. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për vërtetimin e gabuar të fakteve dhe interpretimin dhe aplikimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm lidhur me vërtetimin e pronësisë mbi ngastrat kontestuese kualifikohen si pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “ligjshmërisë”, dhe nuk janë argumentuar në nivel të “kushtetutshmërisë”. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit dhe rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 dhjetor 2020, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJ kërkesën të papranueshme;
- II. T’UA kumtojë këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

Arta Rama-Hajrizi